



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.43, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“GODINË POLIFUNKSIONALE 2, 4, 16 DHE 24 KATE “GARDEN BUILDING”,  
ME VENDNDODHJE NË RRUGËN E KAVAJËS, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Tirana 1 Konstruktion” sh.p.k dhe “Nova Construction 2012” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Godinë polifunksionale 2, 4, 16 dhe 24 kate “Garden Building”, me vendndodhje në Rrugën e Kavajës, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Tirana 1 Konstruktion” sh.p.k dhe “Nova Construction 2012” sh.p.k.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.05, datë 10.11.2017, nuk ndryshon.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELEND A BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

